

**POZICION VAKANT: INXHINIER ELEKTRIK**

DEPARTAMENTI	Departamenti Teknik
POZICIONI	Inxhinier Elektrik

Shoqëria “Kastrati Construction” shpall vakant pozicionin “Inxhinier Elektrik”.

**01. DETYRA SPECIFIKE**

- Ndjek ecurinë e punimeve elektrike në çdo faze: gjatë projektimit, zbatimit dhe kolaudit përfundimtar;
- Planifikon, organizon dhe mbikqyr punën e nënkontraktorëve elektrik për t’u siguruar se të gjitha punimet po kryhen sipas parametrave të përcaktuara;
- Përgatit dhe koordinon gjithë dokumentacionin e duhur tekniko–ligjor për marrjen e lejeve në institucionet përkatëse vendase;
- Jep zgjidhje teknike detajeve të paparshikuara në projekt dhe/ose rekomandon përmirësimin e tyre;
- Koordinon punën midis grupeve të ndryshme instalatore;
- Përgatit dhe monitoron grafikun e zbatimit të punimeve elektrike në përputhje me grafikun e përgjithshëm të projektit;
- Harton dhe kontrollon situacionet mujore;
- Harton dhe mbikqyr mirëmbajtjen periodike të sistemit të instalimeve elektrike gjatë fazës së shfrytëzimit;
- Raporton periodikisht mbi ecurinë e punimeve.

**02. AFTËSI DHE KUALIFIKIME**

- Edukim i lartë në Degën e Inxhinierisë Elektrike;
- Përbën përparësi Liçenca Elektrike;
- Të ketë mbi 7 vite eksperiencë pune si Inxhinier Elektrik;
- Të zotëroj shumë mirë programin AutoCAD dhe paketën “Microsoft Office”;
- Të zotëroj aftësi të shkëlqyera organizative;
- Të zotëroj njohuri të mira të gjuhës angleze (të folur/të shkruar);
- Të jetë i aftë të menaxhojë disa procese njëkohësisht.

Të interesuarit janë të lutur të aplikojnë në: [hr@kastraticonstruction.al](mailto:hr@kastraticonstruction.al).

**Ju faleminderit!**